

### Përmbledhje

Ekonomia e Eurozonës është duke u përballur me krizë ekonomike të një magnitode dhe shpejtësie të paprecedent. Sipas vlerësimeve preliminare të Eurostat-it, aktiviteti ekonomik shënoi rënie prej 3.2 përqind në TM1 2020, rënia më e lartë e shënuar që nga lufta e dytë botërore. Përderisa aktiviteti ekonomik pritej të karakterizohej me dinamika të dobësuar edhe para ballafaqimit me pandeminë globale, rënia e evidentuar në tremujorin e parë kryesisht i'u atribua ndikimit të masave të ndërmarra për të parandaluar shpërndarjen e virusit COVID-19. Kriza e re ekonomike dhe sociale është reflektuar edhe në dinamikën e çmimeve në eurozonë, me ç'rast shkalla e shënuar e inflacionit ishte 0.8 përqind. Me krizë të paprecedent ekonomike në këtë periudhë është duke u ballafaquar edhe rajoni i Ballkanit Perëndimorë, që sipas FMN-së pritet të karakterizohet me rënie prej 5.2 përqind në vitin 2020.

Sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në vitin 2019 shënoi rritje mesatare vjetore prej 4.2 përqind, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga përmirësimet e eksporteve neto. Meqenëse të dhënat zyrtare për TM1 2020 nuk janë publikuar ende, tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi sugjerojnë se rritja ekonomike gjatë këtij tremujori është ngadalësuar kryesisht si pasojë e masave parandaluese ndaj përhapjes së COVID-19. Për tërë vitin 2020, BQK parashikon rënie të aktivitetit ekonomik prej 5.9 përqind. Bazuar në skenarin bazë, tremujori i dytë pritet të pësojë rënie më të lartë, me përmirësim gradual të aktivitetit në TM3 dhe rimëkëmbje modeste në TM4 2020.

Çmimet e konsumit në TM1 2020 shënuan rritje të ngadalësuar prej 1.1 përqind (3.2 përqind në TM1 2019), kryesisht si rezultat i ngadalësimit të rritjes së çmimeve

të ushqimit. Inflacioni bazë shënoi rritje prej vetëm 0.4 përqind në TM1 2020.

Spektori fiskal në TM1 2020 u karakterizua me rritje të hyrave buxhetore prej 2.2 përqind dhe rënie të shpenzimeve buxhetore prej 2.3 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 23.5 milionë euro (6.1 milionë euro deficit në TM1 2019). Borxhi publik ka arritur në 1.2 miliardë euro, që është për 6.8 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.5 përqind, nga 16.3 përqind sa ishte në TM1 2019.

Asetet e sistemit financiar u zvogëluan për 78.1 milionë euro në TM1 2020, kryesisht si pasojë e zvogëlimit të aseteve të sektorit pensional dhe sektorit bankar. Rënia në asetet e sektorit pensional i është atribuuar kryesisht pasojave të pandemisë globale, goditje që u reflektua në humbje të konsiderueshme nga investimet në tregjet e jashtme. Edhe në sektorin bankar, depozitat e mbajtura u zvogëluan krahasuar me periudhën paraprake. Spektori i sigurimeve u karakterizua me rritje të aktivitetit, rritje të nivelit të primeve dhe profitit të realizuar. Në të njëjtën periudhë, sektori mikrofinanciar shënoi rritje më të ngadalësuar të aktivitetit, nivel të kënaqshëm të fitimeve të realizuara dhe nivel të ulët të kredive me probleme.

Në TM3, sektori i jashtëm është karakterizuar me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 2.6 përqind, rritje që kryesisht i atribuohet zvogëlimit të bilanceve pozitive të shërbimeve dhe të ardhurave parësore dhe rritjes së lehtë të deficitit të mallrave. Llogaria e të ardhurave dytësore shënuan rritje. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat shënuan rritje vjetore prej 1.3 përqind, ndërsa IHD-të shënuan rritje prej 60.5 përqind.

## PËRMBAJTJA

<b>Përmbledhje</b> -----	<b>1</b>
<b>Eurozona dhe Ballkani Perëndimor</b> -----	<b>4</b>
<b>Ekonomia e Kosovës</b> -----	<b>6</b>
<b>Sektori Real</b> -----	<b>6</b>
<b>Çmimet</b> -----	<b>9</b>
<b>Sektori Fiskal</b> -----	<b>9</b>
<b>Sektori Financiar</b> -----	<b>10</b>
<b>Sektori i Jashtëm</b> -----	<b>12</b>

## FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Zhvillimet makroekonomike në Eurozonë-----	04
Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 3. Inflacioni I përgjithshëm dhe inflacioni bazë-----	09
Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj-----	12
Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave-----	12
Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	12
Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive-----	13
Figura 8. Remitencat-----	13
Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponentëve-----	14
Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale-----	05
Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit-----	05
Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin-----	09
Tabela 4. Treguesit e zgjedhur makroekonomik-----	16

## **SHKURTESAT:**

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
MF	Ministria e Financave dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
WEO	World Economic Outlook

## Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Tremujori i parë i vitit 2020 u karakterizua me rënie të aktivitetit ekonomik prej 3.2 përqind (figura 1), që njëherësh paraqet edhe tkurrjen më të thellë të aktivitetit ekonomik që nga viti 1995 kur Eurostat-i ka filluar të publikojë këtë seri kohore.



Dinamika e dobësuar e rritjes ekonomike në vendet e eurozonës në vitin e fundit si pasojë e dobësimit të tregtisë globale, ngadalësimit të rritjes ekonomike në Kinë dhe pasigurive të rritura gjeopolitike, u përkeqësua dukshëm këtë tremujor. Masat për parandalim të përhapjes së COVID-10 që nga muaji mars nga shtetet anëtare të Eurozonës u përkthyen në rënie të aktivitetit në pothuajse të gjitha vendet anëtare. Për vitin 2020, kryesisht si pasojë e krizës shëndetësore, ekonomike dhe sociale që ka shkaktuar pandemia, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka parashikuar rënie ekonomike prej 8.7 përqind.

Rënia e aktivitetit ekonomik u përkthye në dinamika të dobëta edhe në nivelin e çmimeve në eurozonë. Në TM1 2020, shkalla mesatare e Indeksit të

Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në Eurozonë ishte 0.8 përqind (1.4 përqind në TM1 2019) (figura 1).

Me qëllim të zbutjes së efekteve të pandemisë dhe asistimit në rikuperim ekonomik përmes mbështetjes së financimit të ekonomisë reale (veçanërisht bizneseve dhe ekonomive familjare), në qershor 2020, BQE morri vendim lidhur me programin e ri të lehtësimit sasior. Ky program, i emërtuar si “Programi për Blerje Emergjente të Aseteve në Pandemi” u rritë në 1,35 miliardë euro, dhe pritet të zgjatë së paku deri në fund të qershorit 2021.

Në anën tjetër, aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka vazhduar të rritet, rritje që është evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 3.9 përqind ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.6 përqind. Në anën tjetër, me rritje të lartë janë karakterizuar edhe depozitat në sistemin bankar, ku depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 7.4 përqind ndërsa depozitat e ekonomive familjare për 5.7 përqind.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, aktiviteti ekonomik në vitin 2019<sup>1</sup> ka shënuar rritje prej 3.4 përqind, që përbën një rritje të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak (4.0 përqind). Ndërsa për vitin 2020, kryesisht si pasojë e krizës ekonomike dhe sociale të shkaktuar nga pandemia COVID-19, FMN ka parashikuar rënie të aktivitetit ekonomik në rajon për mesatarisht 5.2 përqind. Për vitin 2021, FMN parashikon një rikuperim ekonomik në Ballkanin Perëndimor, konkretisht një rritje mesatare prej 6.7 përqind (tabela 1).

<sup>1</sup> Të dhënat për TM1 2020 nuk janë publikuar ende.

**Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale**

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021
Shqipëria	3.8	4.1	2.2	-5.0	8.0
Bosnja dhe Hercegovina	3.1	3.6	2.7	-5.0	3.5
Kosova	4.2	3.8	4.0	-5.0	7.5
Mali i Zi	4.7	5.1	3.6	-9.0	6.5
Maqedonia e Veriut	1.1	2.7	3.6	-4.0	7.0
Serbia	2.0	4.4	4.2	-3.0	7.5

Burimi: FMN, WEO, Prill 2020

Norma mesatare e inflacionit në TM1 2020 ishte 1.0 përqind, që është normë më e ulët krahasuar me 1.8 përqind sa ishte në TM1 2019. Normat më të ulëta të inflacionit ishin evidente në të gjitha vendet (tabela 2). Ky trend i rënies së inflacionit pritet të vazhdojë edhe në tremujorët në vazhdim dhe sipas FMN-së, norma mesatare e inflacionit në vitin 2020 pritet të jetë 0.7.

**Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit**

Përshkrimi	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1
Kosova	0.0	0.7	1.4	2.2	3.2	3.3	2.6	1.7	1.1
Mali i Zi	3.7	3.7	2.4	1.7	0.4	0.5	-0.1	1.1	0.5
Maqedonia e Veriut	2.6	2.3	2.2	1.9	1.9	1.4	0.1	-0.5	-0.1
Serbia	1.6	1.8	2.4	2.0	2.4	2.3	1.3	1.4	1.8
Shqipëria	1.6	1.9	2.1	1.5	2.0	1.5	1.5	1.6	1.9

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, në TM1 2020, norma mesatare e rritjes së kredive ishte 7.6 përqind (7.4 përqind në TM1 2019). Vendet të cilat shënuan normat më të ulëta të rritjes së kreditimit ishin Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi (3.7 përqind përkatësisht 4.3 përqind), ndërsa Kosova dhe Shqipëria shënuan normat më të larta (9.2 përqind përkatësisht 9.1 përqind). Në anën tjetër, depozitat shënuan ngadalësim të rritjes. Norma mesatare e rritjes së depozitave ishte 7.2 përqind në nivel të rajonit (8.6 përqind në TM1 2019). Tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Kosovë dhe Serbi (13.6 përqind përkatësisht 10.1 përqind), pasuar

nga Maqedonia e Veriut me 7.5 përqind, Bosnja e Hercegovina me 7.2 përqind, etj.

Gjatë TM1 2020, euro ka shënuar një vlerësim të lehtë ndaj kunës kroate dhe denarit maqedonas (0.9 përqind përkatësisht 0.1 përqind), ndërsa është zhvlerësuar ndaj valutave tjera kryesore: 5.8 përqind ndaj frankës zvicerane, për 2.9 përqind ndaj dollarit amerikan, 1.5 përqind ndaj lekut shqiptar dhe 1.2 përqind ndaj sterlinës britaneze. Euro shënoi zhvlerësim edhe ndaj dinarit serb për 0.6 përqind në periudhën raportuese.


## Ekonomia e Kosovës

### Sektori Real

Sipas të dhënave tremujore të ASK-së, aktiviteti ekonomik ka shënuar rritje mesatare prej 4.2 përqind në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, kur ishte shënuar rritje prej 3.8 përqind. Në baza sektoriale, rritjen më të lartë e shënuan aktivitetet financiare dhe të sigurimit (12.2 përqind), pasuar nga industria nxjerrëse dhe ajo përpunuese (5.9 përqind secila), tregtia (5.7 përqind) dhe ndërtimtaria (5.6 përqind).

Sipas qasjes së shpenzimeve, aktiviteti ekonomik u mbështet kryesisht nga kontributi pozitiv i komponentës së neto eksporteve (0.2 pikë përqindje kundrejt kontributit negativ prej 3.7 pikë përqindje në vitin 2018). Edhe kërkesa vendore kontribuoi pozitivisht me 2.0 pikë përqindje (3.8 pikë përqindje në vitin 2018) (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK (2020) dhe llogaritjet e BQK-së

Deri në dhjetor 2019, kreditë e reja konsumuese shënuan rënie prej 4.1 përqind, duke ndikuar kështu në ngadalësimin e rritjes së konsumit. Përveç rënies së kredive konsumuese, edhe burimet tjera të financimit të konsumit si kompensimi i punëtorëve dhe

shpenzimet për paga në sektorin publik u karakterizuan me ngadalësim të rritjes. Një burim i rëndësishëm i konsumit, remitencat, u karakterizuan me përsheptim të rritjes. Niveli pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar i investimeve publike dhe IHD-ve ka ndikuar në rritjen më të ngadalësuar të investimeve të përgjithshme. Në anën tjetër, ngadalësimi i rritjes së kërkesës së brendshme ka ndikuar në ngadalësimin e rritjes së importit, ndërkohë që eksporti ka shënuar rritje të përsheptuar. Kjo ka bërë që eksportet neto të shënojnë deficit më të ulët tregtarë prej rreth 0.8 përqind në terma real.

### Hapësirë informuese: Vlerësimi i ndikimit të masave të parandalimit të COVID-19 në aktivitetin ekonomik

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2020 është duke u përballur me krizën ekonomike dhe sociale të shkaktuar nga pandemia COVID-19. Masat kufizuese mbi lëvizjen e qytetarëve dhe mbyllja e aktiviteteve të caktuara ekonomike, kanë shkaktuar shok ekonomik, të transmetuar nga kanalet e jashtme si dhe kërkesa e brendshme. Veçanërisht, struktura e ekonomisë së Kosovës, e cila ka varshmëri të lartë nga të ardhurat nga jashtë (eksporti i shërbimeve dhe remitencat, të cilat së bashku përbëjnë afër një të tretën e BPV-së), e bënë atë shumë të ndjeshme ndaj këtij shoku global. Vlerësimi i përmasave të ndikimit ekonomik vazhdon të jetë i vështirë dhe sfidues, pasi që ende ka pasiguri rreth jetëgjatësisë së pandemisë – konkretisht nëse do të arrihet të tejkalohet me valën e parë gjatë tremujorit të dytë të vitit, apo nëse do të ketë valë të re të përhapjes së virusit. Bazuar në supozimin bazë që masat kufizuese do të tërhiqen në fund të tremujorit të dytë, parashikimet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti

ekonomik pritet të zvogëlohet për 5.9 përqind në vitin 2020. Me heqjen e masave kufizuese, parashikohet një rikuperim gradual i aktivitetit ekonomik, megjithëse shpejtësia dhe shkalla e rikuperimit mbeten shumë të pasigurta.

Mbështetur në tregues me frekuencë më të lartë publikimi, BQK vlerëson se aktiviteti ekonomik në TM1 2020 ka ngadalësuar ritmin e rritjes në 3.1 përqind (nga 4.2 përqind në TM1 2019), ndikuar nga efektet e masave parandaluese ndaj COVID-19 në kërkesën e brendshme, si dhe rritjen e lehtë e deficitit të eksporteve neto. Masat kufizuese kanë ndikuar në tkurrje të aktivitetit ekonomik veçanërisht në muajt prill dhe maj, andaj ndikimi më i theksuar negativ i pandemisë COVID-19 pritet të materializohet në TM2, me efekte negative në ekonomi të bartura edhe në TM3 2020. Aktiviteti ekonomik pritet të rifilloj rritjen pozitive në TM4, bazuar në supozimin që masat kufizuese nuk do të rikthehen. Sidoqoftë, shtrirja e tkurrjes dhe rikuperimi do të varet në mënyrë thelbësore nga kohëzgjatja e pandemisë, masat e kontrollit dhe efektet në sjelljen e individëve, dhe suksesi i politikave në zbutjen e ndikimit të pafavorshëm në të ardhura dhe punësim.

Parashikimet sugjerojnë se konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënoj rënie reale prej 2.9 përqind në vitin 2020, bazuar në pritjet që konsumi publik do të zvogëlohet me 2.5 përqind dhe konsumi privat me 3.0 përqind. Shpenzimet për paga në sektorin publik janë rritur për pagesën shtesë që i është bërë një pjese të stafit të sektorit publik që kanë qenë më të ekspozuar ndaj virusit, ndërsa tek shpenzimet për mallra dhe shërbime pritet që të ketë kursime nga ajo që është

buxhetuar. Sa i përket konsumit privat, rënia pritet të shkaktohet si nga faktor me ndikim direkt (masat e ndërmarrja nga qeveria për të shmangur grumbullimin e njerëzve përmes mbylljes së tregjeve, ndalimit të ushtrimit të veprimtarive të shumë bizneseve si gastronominë, transportin, etj.), ashtu edhe nga faktor indirekt (rënia e të ardhurave të disponueshme si pasojë e rritjes së potenciale të papunësisë dhe/apo zvogëlimit të pagave në sektorin privat, zvogëlimit të kreditimit për shkak të rritjes së rreziqeve të perceptuara, etj.). Gjithashtu, si pasojë e karakterit global të pandemisë, edhe burimet e jashtme të financimit të konsumit pritet të shënojnë rënie si pasojë e rënies së aktivitetit ekonomik në vendet ku janë të lokalizuar emigrantët kosovar, kufizimit të lëvizjes si masë parandaluese për përhapjen e COVID-19 dhe potencialisht qasjes mbrojtëse që mund të kenë individët kundrejt rrezikut. Remitentat pritet të shënojnë rënie prej 4.7 përqind ndërsa kompensimi i punëtorëve pritet të shënoj rënie prej 11.1 përqind. Ndikimi i COVID-19 në konsumin privat në periudhë afatmesme shoqërohet nga shumë pasiguri, ndër tjera, nga dinamikat në sjelljen e konsumatorëve dhe efektiviteti potencial i politikave publike.

Investimet pritet të karakterizohet me rënie reale prej 12.1 përqind gjatë vitit 2020, bazuar në parashikimet për rënie të konsiderueshme të investimeve publike (22.1 përqind) dhe investimeve private (9.0 përqind). Shpenzimet kapitale të qeverisë pritet që të kenë normë të ulët të realizimit (62 përqind), normë që mund t'i atribuohet: aprovimit të vonshëm të buxhetit (vetëm në muajin mars është aprovuar buxheti nga Kuvendi i Kosovës); pritjeve për rënie të të hyrave buxhetore si pasojë e ndalimit të veprimtarisë së një



numri të madh të bizneseve dhe rënies së importit; pritjeve që një pjesë e shpenzimeve kapitale të përdoren për qëllime të tjera duke prioritetizuar mbi zbutjen e efekteve negative në ekonomi të COVID-19. Tkurrrja ose ndërprerja e tërësishme e aktivitetit në sektorin e shërbimeve pritet të ndikoj në rënie të investimeve private. Ngadalësimi i prodhimit si pasojë e vështirësive në furnizim si dhe kufizimit të lëvizjes pritet të ndikojnë që kostot e të bërit biznes të jenë më të larta, ndërkohë që sipas anketës së kreditimit bankar, mund të ketë edhe shtrëngim të kreditimit deri në një masë gjatë tremujorit të dytë të vitit. Gjithashtu, edhe Investimet e Huaja Direkte pritet të shënojnë rënie (10.1 përqind). Analizuar në këndvështrim sektorial, shërbimet (veçanërisht turizmi, transporti dhe shërbimet rekreative dhe kulturore), pritet të ndikohen në masë të madhe nga masat e ndërmarra për të parandaluar përhapjen e virusit. Rënia e fluksit të parave, mos aftësia paguese e detyrimeve dhe falimentimi i mundshëm i kompanive pritet të ndikoj negativisht vendimet e ardhshme për investime.

Të dhënat për ecurinë e tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve për TM1 2020, sugjerojnë për ngadalësim të rritjes. Megjithatë, shenjat e hershme të një përmirësimi të bilancit tregtarë në fillim të vitit 2020 u ndryshuan nga efektet e pandemisë. Gjatë muajit janar dhe shkurt është shënuar rritje shumë e lartë, si në eksport (19.9 përqind) ashtu edhe në import (14.9 përqind), ndërsa në muajin mars, kur edhe filluan masat shtrënguese për shkak të pandemisë, eksporti i mallrave dhe shërbimeve shënoi rënie për 31.4 përqind kurse importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rënie për 12.7 përqind. Duke pasur parasysh këtë trend të

rënies së eksportit dhe importit si dhe paralizimin e ekonomisë që ka shkaktuar COVID-19 sidomos gjatë TM2 2020, tregtia e jashtme pritset të dobësohet veçanërisht në TM2 2020. Për tërë vitin 2020, deficitin tregtar i mallrave dhe shërbimeve pritset të ngushtohet në terma real për 2.5 përqind. Përcaktuese pritset të jetë rënia e pritur e vlerës së importit të mallrave dhe shërbimeve për 7.9 përqind (mallrat -6.1 përqind, shërbimet -16.4 përqind). Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritset të shënoj rënie prej 13.7 përqind (mallrat -12.1 përqind, shërbimet -14.1 përqind). Kjo rënie e eksportit, veçanërisht rënia e eksportit të shërbimeve të udhëtimit (shpenzimet e diasporës në Kosovë), pritset të ketë pasoja të rënda për ekonominë e Kosovës kur kemi parasysh varësinë e lartë që ka Kosova ndaj eksportit të këtyre shërbimeve.


Sipas vlerësimit të ASK-së, norma mesatare inflacionit gjatë periudhës janar-prill 2020 ra në 0.9 përqind, nga 3.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2019. Kjo rënie e shkallës së inflacionit është nxitur kryesisht nga rënia e çmimeve të naftës, si dhe ngadalësimi i rritjes së çmimeve të ushqimit. Rënia e aktivitetit ekonomik pritset të ndikoj në dobësim të dinamikave të çmimeve gjatë muajve të ardhshëm. Pritjet e BQK-së janë se norma mesatare e inflacionit për vitin 2020 do të jetë 0.8 përqind. Sidoqoftë, implikimet e pandemisë COVID-19 për inflacionin janë të shoqëruara nga një pasiguri e lartë, duke pasur parasysh që presionet në rënie, si pasojë e dobësimit të kërkesës së përgjithshme, mund të kompensohen pjesërisht nga presionet në rritje që lidhen me ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit.



## Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit shënoi rritje të ngadalësuar prej 1.1 përqind në TM1 2020, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2019 kur ishte shënuar rritje prej 3.2 përqind (figura 3).

Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2020)

Rritja më e lartë është shënuar tek çmimet e shërbimeve të shëndetësisë, hotelarisë, orendive shtëpiake si dhe mallrave dhe shërbimeve tjera, të cilat kontribuuan me 0.48 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm. Kategoritë tjera shënuan rritje të ngadalësuar të çmimeve gjegjësisht rënie. Çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike shënuan rritje dukshëm më të ulët në TM1 2020 (1.6 përqind) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 (6.4 përqind), mirëpo, për shkak të peshës së madhe në shportën e konsumatorit, kontribuuan pozitivisht me 0.67 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm (tabela 3).

Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin

Përshkrimi	Peshat 2020	Norma e inflacionit	Kontributi
<b>GJITHSEJ</b>	<b>100.0%</b>	<b>1.1</b>	<b>1.07</b>
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	40.1%	1.6	0.67
Pijet alkoolike dhe duhani	5.7%	-0.2	-0.01
Veshmbathja	4.1%	-0.6	-0.02
Energjia	7.7%	-0.3	-0.02
Orenditë	7.6%	2.0	0.15
Shëndetësia	2.1%	4.2	0.09
Transporti	15.7%	-0.1	-0.02
Komunikimi	3.8%	1.0	0.03
Rekreationi	4.4%	-0.3	-0.01
Arsimi	1.0%	0.1	0.00
Hoteleria	3.2%	2.5	0.08
Mallrat dhe shërbimet tjera	4.5%	3.7	0.16

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

Siç shihet në tabelë, shporta e konsumatorit kosovarë karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqim, energji, pije alkoolike dhe duhan), dhe përjashtimi i këtyre komponentëve bënë që inflacioni bazë të jetë më stabil (figura 3). Në TM1 2020, inflacioni bazë rezultoi të jetë 0.4 përqind, apo 0.7 pikë përqindje më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm.

Për shkak të varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamikat e shportës së konsumatorit kosovarë përcaktohen kryesisht nga lëvizja e çmimeve të importit, të cilat në TM1 2020 shënuan rënie mesatare prej 0.6 përqind (3.4 përqind rritje në TM1 2019). Përveç çmimeve të importit me rënie prej 0.2 përqind janë karakterizuar edhe çmimet e prodhimit por që kjo normë e rënies ishte më e ulët krahasuar me çmimet e importit.

### **Sektori Fiskal**

Të hyrat buxhetore<sup>2</sup> në TM1 2020 arritën vlerën neto prej 397.3 milionë euro (rritje vjetore prej 2.2 përqind), ndërsa shpenzimet buxhetore<sup>3</sup> arritën vlerën prej 373.7 milionë euro ( rënie vjetore prej 2.3 përqind). Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 23.5 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 6.1 milionë euro në TM1 2019.

Në kuadër të të hyrave tatimore, rritje prej 3.3 përqind është shënuar tek të hyrat tatimore indirekte, të cilat arritën vlerën prej 294.1 milionë euro. Të hyrat tatimore indirekte janë të lidhura kryesisht me importin e mallrave, dhe përbëjnë rreth 74.0 përqind të gjithëj të hyrave buxhetore. Në anën tjetër, të hyrat tatimore direkte shënuan rënie prej 3.4 përqind dhe shënuan vlerën prej 65.9 milionë. Edhe të hyrat jostatimore shënuan rënie prej 2.1 përqind, duke shënuar vlerën prej 44.8 milionë euro.

Rënia e lehtë e shpenzimeve buxhetore kryesisht i atribuohet vonesave në aprovimin e Buxhetit për vitin 2020 nga ana e Kuvendit të Kosovës. Kategoria kryesore që kontribuoi në rënie shpenzimeve buxhetore ishte ajo e shpenzimeve kapitale, shpenzime që shënuan vlerën prej 28.4 milionë euro dhe u karakterizuan me rënie prej 34.9 përqind kundrejt TM1 2019. Me rënie prej 5.9 përqind u karakterizuan edhe shpenzimet për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale), të cilat arritën nivelin prej 46.9 milionë euro. Kategoritë tjera të shpenzimeve buxhetore shënuan rritje. Shpenzimet qeveritare për

paga shënuan rritje prej 3.5 përqind dhe arritën vlerën prej 154.6 milionë euro, përderisa subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 3.0 përqind dhe arritën vlerën prej 143.9 milionë euro.

Borxhi publik në TM1 2020 ka arritur në 1.2 miliardë euro, që është për 6.8 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.5 përqind nga 16.3 përqind sa ishte në TM1 2019. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 12.9 përqind (që ka arritur në 792.0 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka rënë në 399.3 milionë euro gjegjësisht për 3.6 përqind kundrejt TM1 2019. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithëj borxhin publik është zvogëluar në 33.5 përqind, nga 37.1 përqind sa ishte në TM1 2019. Pragu i borxhit publik i paraparë me ligj në Kosovë është 40 përqind, rrjedhimisht niveli i borxhit publik prej 16.5 e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit.

### **Sektori Financiar<sup>4</sup>**

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u zvogëluar për 78.1 milionë euro, kryesisht ndikuar prej sektorit pensional (-56.5 milionë euro) dhe sektorit bankar (-33.8 milionë euro). Zvogëlimi i aseteve të këtyre dy sektorëve, e veçanërisht për sektorin pensional, kryesisht i atribuohet humbjeve të konsiderueshme nga investimet në tregjet e jashtme me shpalljen e gjendjes pandemike në nivel global. Megjithëse me efekt të kufizuar, duke qenë se mbyllja

<sup>2</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>3</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

<sup>4</sup> Për më shumë informata rreth zhvillimeve në sektorin financiar referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiarë (TM3 2019) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

e ekonomisë filloi vetëm në dy javët e fundit të muajit mars 2020, sektori bankar shënoi rënie të depozitave të mbajtura në sektorin bankar në TM1 2020 krahasuar me periudhën paraprahe. Në TM1 2020, performanca e sektorit bankar ishte mjaftë profitabile, duke gjeneruar fitim neto në vlerë prej 21.7 milionë euro. Rritja më e lartë e nivelit të hyrave, prej 11.8 përqind (kryesisht nga interesi në kredi), krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të shpenzimeve, prej 11.0 përqind (kryesisht nga jointerеси dhe shpenzimeve operative), ndikoi që sektori të realizonte fitime neto në vlerë rekorde gjatë tremujorit të parë të vitit. Treguesit e shëndetit financiar të sektorit vazhdojnë të jenë në vlera optimale. Sektori bankar vazhdon të karakterizohet me cilësi të lartë të portfolios kreditore, me nivel të ulët të kredive joperformuese dhe mbulueshmëri të kënaqshme me provizione. Indikatorët e solvencës dhe likuiditetit, megjithëse shënuan rënie, vazhdojnë të jenë mbi nivelet minimale të rekomanduara me rregullore.

Megjithëse për ekonominë reale dhe sektorin bankar ndikimi i masave të aplikuara për mospërhapjen e virusit Covid-19 do të evidentohen në masë të madhe në TM2 2020, sektori pensional u ndikua edhe gjatë TM1. Struktura e aseteve të sektorit pensional është e përbërë kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit, gjë që ndikoi që luhatjet negative në tregjet financiare globale si pasojë e pasigurisë së shkaktuar nga kriza e pandemisë të përkthehen në kthim negativ nga investimet e për pasojë, rënie të aseteve të sektorit. Faktorë me ndikim pozitiv në asetet e sektorit ishin kontributet e reja pensionale, të cilat shënuan rritje gjatë këtij tremujori.

Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, edhe pse në nivel më të ulët. Niveli i primeve të shkruara ishte më i lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprahe, ndikuar nga rritja e çmimeve të primeve të sigurimit të detyrueshëm të automjeteve në fund të vitit të kaluar. Sektori i sigurimeve shënoi rritje të profitit në këtë tremujor, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të dëmeve të ndodhura dhe reduktimit të shpenzimeve tjera operative, që mund të jenë ndikuar dhe nga ndërmarrja e masave parandaluese për përhapjen e COVID-19 në dy javët e fundit të TM1 2020.

Në periudhën raportuese, me rritje me të ngadalësuar u rrit edhe sektori mikrofinanciar, kryesisht si pasojë e ngadalësimit të rritjes së kreditimit (veçanërisht për ekonominë familjare). Aktiviteti kreditor i sektorit u ndikua nga pasiguritë e rritura me gjendjen pandemike dhe masat e ndërmarra nga institucionet e vendit për parandalimin e përhapjes së virusit, megjithëse masat u aplikuan vetëm në dy javët e fundit të këtij tremujori. Sektori realizoi nivel të kënaqshëm të fitimeve neto në këtë tremujor, përderisa niveli i kredive me probleme në fund të periudhës (mars 2020) ka shënuar rritje krahasuar me periudhën paraprahe (mars 2019) e po ashtu edhe me tremujorin paraprahe (dhjetor 2019). Megjithatë, kreditë me probleme mbeten në nivele mjaftë të ulëta dhe mirë të provizionuara.


Në tregun e letrave me vlerë, shuma e borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës arriti vlerën prej 55 milionë euro, që është dukshëm më e ulët se në TM1 2019. Si pasojë e vonësës së formimit të institucioneve në fillim të vitit 2020, kërkesa nga ana e Qeverisë ishte

më e ulët pasi që ofertat prej akterëve kryesor në tregun e letrave me vlerë tejkaluan shumën e kërkuar.

### Sektori i Jashtëm

Në TM1 2020, deficitin e llogarisë rrjedhëse ishte 84.6 milionë euro, që është për 2.6 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2019. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet zvogëlimit të bilanceve pozitive të shërbimeve dhe të ardhurave parësore, si dhe rritjes së lehtë të deficitit të mallrave. Në këtë periudhë, të ardhurat dytësore shënuan rritje (figura 4).

Figura 4. Deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro




Burimi: BQK (2020)

Deficitin në llogarinë e mallrave<sup>5</sup> arriti vlerën prej 639.6 milionë euro në TM1 2020, që paraqet një rritje vjetore prej 0.7 përqind (8.5 përqind rritje në TM1 2019). Kjo rritje më e ngadalësuar e deficitit të mallrave ishte për shkak të rritjes dukshëm me të lartë të eksportit të mallrave dhe rritjes së ngadalësuar të importit, për dallim nga periudha e njëjtë e vitit 2019 kur ishte shënuar rritje më e lartë e importit të mallrave krahasuar me eksportin.

Vlera e eksportit të mallrave arriti në 97.0 milionë euro një rritje e konsiderueshme vjetore prej 25.9 përqind (5.1 përqind rritje në TM1 2019) (figura 5).


Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK (2020)

Rritja e eksportit të mallrave ishte më e theksuar tek metalet bazë, produktet e plastikës dhe gomës si dhe ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani. Në anën tjetër, rënie shënoi eksporti i produkteve minerale, eksporti i lëkurës dhe artikujve të lëkurës, etj. (figura 6).

Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2020)

Vlera e importit të mallrave arriti në 736.7 milionë euro, që paraqet një rritje të ngadalësuar prej 3.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit

<sup>5</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

paraprak kur ishte shënuar rritje prej 8.2 përqind. Në ngadalësimin e rritjes së importit të mallrave ka ndikuar kryesisht niveli më i ulët i importit të produkteve minerale (kryesisht derivate të naftës) dhe metaleve bazë, kategori të cilat janë karakterizuar me rënie të çmimeve gjatë TM1 2020. Në anën tjetër, importi i ushqimeve të përgatitura, pijeve, duhanit, importi i perimeve si dhe importi i makinerive dhe pajisjeve elektrike ka shënuar rritje (figura 7).

Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2020)

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 137.8 milionë euro, që paraqet rënie prej 11.5 përqind krahasuar me TM1 2019. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rënie vjetore prej 3.1 përqind, dhe shënoi vlerën prej 273.2 milionë euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoi rritje prej 7.1 përqind dhe arriti në 135.5 milionë euro.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore shënoi vlerën prej 46.0 milionë euro, një rënie prej 12.3 përqind. Bilanci i të ardhurave dytësore arriti në 312.1 milionë euro, që është për 8.3 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2019. Rritja e bilancit të të ardhurave dytësore ishte e evidente në muajt janar dhe shkurt, dinamikë që u ndërroi në mars më pas me

shpalljen e masave parandaluese të përhapjes së virusit COVID-19. Remitencat e pranuar në Kosovë shënuan vlerën prej 187.3 milionë euro, një rritje prej 1.3 përqind kundrejt TM1 2019 (figura 8). Remitencat në muajin janar dhe shkurt shënuan rritje dyshifrore, ndërsa në muajin mars shënuan rënie prej 13.9 përqind.

Figura 8. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2020)


Remitencat që pranohen në Kosovë kryesisht vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, prej nga u dërguan 42.4 përqind përkatësisht 20.8 përqind e gjithsej remitencave në TM1 2020. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.3 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Llogaria financiare e bilancit të pagesave shënoi vlerën prej -86.3 milionë euro (-23.9 milionë euro në TM1 2019). Kjo rritje e bilancit negativ në llogarinë financiare ishte kryesisht rezultat i zvogëlimit të investimeve jashtë Kosovës, qofshin investime portfolio, asete rezervë apo investime direkte. Edhe detyrimet në kuadër të llogarisë financiare shënuan rritje (32.4 përqind). Në kuadër të llogarisë financiare, IHD-të në Kosovë arritën vlerën prej 112.0 milionë euro që janë për 60.5 përqind më e lartë krahasuar me

**Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike  
Nr. 30, Tremujori I/2020**

TM1 2019. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 74.5 milionë euro dhe shënoi rritje prej 55.1 përqind, ndërsa IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan rritje vjetore prej 72.5 përqind dhe arritën vlerën prej 37.5 milionë euro (figura 9).

Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2020)

Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht tek sektorët e energjetikës, minierave, patundshmërive si dhe shërbimeve financiare, ndërsa sektori i ndërtimit dhe ai i industrisë shënuan rënie. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Hungaria paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në TM1 2020 (24.9 milionë euro), pasuar nga Gjermania (20.4 milionë euro), Shqipëria me 16.0 milionë euro, Zvicra me 12.0 milionë euro, SHBA-të me 7.7 milionë euro, etj.

**Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2020): Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike nr. 30, TM1 2020, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

**Referencat:**

BQK (2020):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2020):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/media/5373/ihck-mars-2020-shqip.pdf>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/media/5438/indeksi-i-çmimeve-te-prodhimit-tm1-2020-shqip.pdf>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/media/5432/indeksi-i-çmimeve-të-importit-içimp-tm1-2020.pdf>
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/media/5391/rep-stat-mbi-ndër-ekono-në-kosovë-tm1-2019.pdf>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/media/5382/statistikat-e-tregtisë-së-jashtme-stj-mars-2020.pdf>

IMF (2020): World Economic Outlook:

<https://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2020/01/weodata/index.aspx>



## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM1 2019	TM1 2020
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	6,726.1	7,079.6
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	3.2%	1.1%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	3.2%	0.8%
Sektori fiskal* 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	388.5	397.3
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	382.5	373.7
Bilanci primar (në milionë euro)	6.1	23.5
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	6,513.1	7,174.0
prej të cilave: Bankat	4,229.1	4,721.9
Kredi	2,824.1	3,083.3
Depozita	3,383.7	3,845.4
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.7%	6.3%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.5%	1.3%
Hendeku i normës së interesit	5.2%	5.0%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-86.5	-82.7
prej të cilave: remitencat e pranuar	184.9	187.3
Llogaria financiare	-23.9	-86.3
Investimet e huaj direkte në Kosovë	69.8	112.0
Investimet portfolio, net	71.1	-17.4
Investimet tjera, net	-152.2	54.1
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-409.4	-401.6
Asetet	4,766.2	5,162.7
Detyrimet	5,175.6	5,564.3
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,035.7	2,179.4
Borxhi i jashtëm privat	1,537.3	1,680.4
Borxhi i jashtëm publik	498.4	499.0

Burimi:

1/ ASK (2020).

2/ MF (2020).

3/ BQK (2020).

\*Të dhënat për BPV, PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në dhjetor 2019.

